



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor  
Prof. dr. MarjanDema

Nr. Prot. 577  
Datë: 7 / 3 / 2019

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.03.2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Revista shkencore "Acta Universitatis Danubius", duke filluar nga data 01.03.2019, nuk do të merret në konsideratë për vlerësim me rastin e emërimit, riemërimit dhe avancimit të personelit akademik si dhe për aprovimin e punimit të doktoratës së doktorantëve të UP-së.
- II. Vendimi i Senatit nuk mund të shfrytëzohet për të dëmtuar autorët dhe reputacionin e tyre për punimet e publikuara dhe konfirmuara për publikim deri në datën 01.03.2019, duke pasur parasysh se revista ka qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara me udhëzimin administrativ të MASHT-it nr. 01/2018 si dhe rregulloren e UP-së për procedura përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, me nr. prot. 456, dt. 02.03.2018.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në senat dhe nuk ka efekt retroaktiv për publikimet e bëra deri në datën 01.03.2019 në revistën shkencore të shënuar si më sipër.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur në datën 01.03.2019, pasi e shqyrtoi propozimin e Komisionit Qendror për Studime të Doktoratës, konstatoi se revista shkencore me titull: "Acta Universitatis Danubius", edhe pse është e listuar në databazat e përcaktuara nga Senati i UP-së, nga data 01.03.2019, nuk do të merret në konsideratë për publikim të punimeve shkencore dhe, si rezultat i saj, nuk do të merret në konsideratë me rastin e emërimit, riemërimit dhe avancimit të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", si dhe për aprovimin e punimit të doktoratës së doktorantëve të UP-së.

Ky vendim merret me qëllim të avancimit të mëtejshëm të punimeve shkencore, prandaj Senati i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. KQSD-së;
3. Njësive akademike të UP-së;
4. Zyrës për Çështje Akademike;
5. Zyrës Ligjore të UP-së;
6. Uebfaqe të UP-së.



Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. dr. Marjan Dema – rektor i UP-së